

- Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin e bërë publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.
- Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal, ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.
- Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Kërkesa për informim duhet të përmbajë:
 1. emrin dhe mbiemrin e kërkuarit;
 2. adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
 3. përshkrimin e informacionit që kërkohet;
 4. formatin në të cilin preferohet informacioni;
 5. çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.
- Kërkesa për informim trajtohet nga ana e AP sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.
- Kur kërkesa është e paqartë në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e saj, AP kontakton menjëherë personin për të bërë sqarimet e nevojshme, por gjithnjë jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës.
- Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës AP konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ajo, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, vë në dijeni kërkuarin për këtë, si dhe mund t'i sugjerojë atij që t'i drejtohet Autoritetit kompetent.
- Shërbimet e trajtimit të kërkesave për informacion janë pa pagesë. Dhënia e informacionit mund të bëhet nëpërmjet informacionin shkruesor dhe elektronik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut.
- E drejta e informimit kufizohet vetëm sipas rasteve të parashikuara në nenin 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.
- Ankimi administrativ pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur:
 1. ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit;
 2. ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.